

PERMBLEDHJE JOTEKNIKE E VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJEDIS Aktiviteti : Shfrytezimi i mineralit Grabo



Vendodhja e ushtrimit te aktivitetit : Gjobardhaj, Ungrej,Lezhe

Investitor: GJONI shpk

Lezhe 2022

PERMBAJTJA

Hyrje

- a) **Pershkrim i shkurter i mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet projekti**
- b) **Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj**
- c) **Nje identifikim te ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, toke, uje, ajer.**
- d) **Nje pershkrim te shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si , ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurme, si dhe prodhimin e mbetjeve**
- e) **Informacion per kohezgjatjen e mundshme te ndikimeve negative te identifikuara**
- f) **Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te**
- g) **Mundesine e rehabilitimit te mjedisit te ndikuar dhe mundesine e kthimit te siperfaqes te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e meparshme, perfshire edhe token bujqesore , si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin**
- h) **Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis**
- i) **Ndikimet e mundshme ne mjedisin nderkufitar (nese projekti ka natyre te tille)**

HYRJE

Subjekti “ **GJONI** ”shpk është një shoqëri vendase regjistruar pranë Qendres Kombetare të Biznesit me NIPT; J98220509M dhe administrator Kole Toli.

Subjekti është i pajisur me Leje Mjedisore me datë 07.09.2021 , nr.6100 Prot, Nr. Identifikimi të Lejes 3725 , Komision nr.37 për aktivitetin “ Nxjerrja e mineraleve, reres dhe argjiles nga minierat meshfrytezimneqie të hapur dhe nga guroret”, me vendodhje Fshati Gjobardhaj, Ungrej, Lezhe dhe sipërfaqe 0.038 km².

Duke qen se rezervat e mineralit gabro gjenden edhe jashtë sipërfaqes së miratuar për shfrytëzim, subjekti ka aplikuar pranë MIE-se për zgjerimin e sipërfaqes së shfrytëzimit, kërkesë e cila është miratuar, me datë 23.12.2021 ,nr.7526/1 prot me Lende “Njoftim për fillim procedurë për zgjerimin e lejes minerare nr.1488/1 date 02.08.2010”. Sipërfaqja e shfrytëzimit ishte 0.038 km² dhe bëhet 0.074 km².

Sa me sipër subjekti GJONI shpk i është drejtuar AKM- së lidhur me procedurën që duhet të ndjek dhe me shkresën me nr.127/1 prot date 17.01.2022 i është komunikuar se duhet të nënshtrohet procedurës Paraprake të VNM-se, bazuar në ligjin nr.10440 date 07.07.2021 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, Neni 8 , projektet që I nënshtrohen vlerësimit paraprak të VNM-se janë:

b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht , që mund të shkaktojnë efekte të rëndësishme negative në mjedis.

Qëllimi i VNM- së

Qëllimi i hartimit të raportit të VNM-se është përcaktimi i efekteve negative dhe pozitive të aktivitetit dhe masat e duhura për përmirësimin dhe zvogëlimin e ndikimeve në mjedis si rezultat i zhvillimit të projektit të shfrytëzimit të mineralit.

VNM nuk do të mbulojë çdo aspekt të një efekti mjedisor të projektit, me të njëjtin nivel detajesh. Thëksi do të vihet në ndikimet kryesore që shkakton zhvillimi i aktivitetit.

Gjithashtu një synim tjetër është të përcaktojë e rekomandojë masat teknike- organizative për zbutjen e anëve negative që mund të krijohen gjatë zhvillimit të aktivitetit dhe të japë informacion për vendim-marrësit për pasojat mjedisore të aktiviteteve të propozuara.

Objektivat e VNM

Objektivat e hartimit të VNM- së konsistojnë në evidentimin dhe reduktimin e ndikimeve në mjedis dhe masat tekniko-organizative për një zhvillim të qëndrueshëm të mjedisit, gjatë kryerjes së aktivitetit minerar deri në përfundim të aktivitetit dhe rehabilitimin e hapësirës së shfrytëzuar dhe të prekur nga aktiviteti, për një mjedis të qëndrueshëm në vitet pas ardhese.

Me këtë studim informojmë organet vendim-marrëse, mbi ndikimet në mjedis dhe përfitimet e projektit të propozuar. Gjithashtu zhvillimin e qëndrueshëm duke siguruar që zbatimi i projektit nuk prek burimet natyrore dhe funksionet ekologjike ose mireqenien, stilin e jetes dhe jetesën e komunitet si dhe të njerezëve që lidhen apo varen nga ky projekt ose veprimtari.

Vendndodhja e objektit

Objekti i gabrove ndodhet 6-km ne veriprendim te komunes Ungrej, 1km ne lindje te fshatit Gjobardhaj dhe 2km ne V- L te qendres Kalivaç, 20km larg fshatit Kallmet dhe 28km ne V- L te qytetit Lezhe. Si objekt perfsihet ne rajonin e Kashnjetit.

Ai vendoset ne fund te shpatit ne bri te meanders se prrojit te Vomsit qe shpesh quhet ne kete ane “ Prroji i Mullirit” , duke qene se ne distance 500m ne JL te objektit ka patur nje mulli bloje.

Pjesa e ngritur e objektit ka emerim nga banoret e zones “ Podi i Udhes “. Per lartesi vendoset siper nivelit te prrojit te Mullirit 2-3m ne kuoten 280 deri 340m mbi nivelin e detit.

Objekti nuk ka rruge automobilistike deri 1km ne JP te tij. Rruga automobilistike lidhet me Kalivaçin ne JP dhe Gjobardhajt ne Prendim. Terreni deri afer objektit eshte me kalushmeri te mire. Sheshi i kerkuar ndodhet ne distance nga 500 - deri 750m larg shtepive te banimit dhe nuk eshte prone individuale.


Kordinatat e vendodhjes jane si meposhte:

Nr.	X	Y
1	4644175	4399550
2	4644350	4399710
3	4644325	4399870
4	4644393	4399870
5	4644310	4400130
6	4644350	4400200
7	4644293	4400227
8	4644190	4399880
9	4644275	4399800
10	4644100	4399640





**HARTA TOPOGRAFIKE ME KONTURET E LEJES MINERARE NR. 1488/1
DHE ATO TE KERKUARA PER ZGJERIM, OBJEKTI "UNGREJ", LEZHE
Shk 1: 25 000**



Ne zgjedhjen e sistemit te shfrytezimit jane mare parasysh:

- Kushtet tekniko-minerare te objektit;
- Menyra e ngarkimit, transportit dhe depozitimit te sterilit.
- Menyra e kryerjes se punimeve te zbulimit;
- Menyra e ngarkimit dhe transportit te blloqeve te gabrove ne brendesi te karrieres dhe jashte saj.
- Mjetet e ngarkimit dhe transportit qe parashikohen te perdoren ne zbulim dhe prodhimin e blloqeve.
- Menyren e rrezimit dhe shkeputjes se blloqeve

Kapaciteti Prodhues

Prodhimi I parashikuar te realizohet nga shfrytezimi i ketij vendburimi ne zonen e kerkuar do te kete si destinacion perdorimin e tij ne industrine e prodhimit te materialeve te ndertimit, kryesisht blloqe e pllaka dekorative per ndertim e veshje.

Per vitin e pare te aktivitetit te saj karriera do te punoje me nje intensitet me te larte per realizimin e zbulimit, i cili siq parashikohet me poshte do te realizohet qe ne vitin e pare

Ne percaktimin e kapacitetit nxjerrtes te minieres, eshte marr parasysh

- Rezervat e vendburimit
- Jetegjatesia e karrieres dhe kohezgjatja e lejes minerare
- Kerkesat e tregut te ketij produkti ne zonen per rreth
- Mundesite financiare te subjektit.

Nisur nga faktoret e me siperm si dhe ne marrveshje me subjektin e interesuar kemi pranuar qe kapaciteti vjetor ne objekt eshte percaktuar ne perputhje me nevojat aktuale te tregut te sigurura deri me tani dhe subjekti parashikohet te jete $2000\text{m}^3/\text{vit}$.

Investimet e kryera per 11 vitet e para te zoterimit te lejes

Ndertim rrugesh te brendshme te karrieres (trashe kapitale), ndertim te sheshit te makinerive dhe themeleve te makinerive.

Eshte realizuar lidhja e objektit me rrugen egzistuese ne dy drejtime me gjatesi 170 m 170 ml x1300leke = 221 000 leke .

Eshte realizuar hapja e transhese kryesore nga kuota + 300 m. deri ne kuoten +330 m.me gjatesi 415 m.

Transhea kapitale ne zonen e projektuar(blloku 1 dhe blloku 2) do te zhvillohen nga horizonti +300 deri ne horizontin +320 me keto elementet kryesore :

Gjatesia e transhese 410 ml.

Madhesia dhe forma e seksionit terthor gjysem seksioni.

Pjerresia gjatesore 8 – 10 % .

Gjeresia e transhese 5-6 m.

Rrezja minimale e serpentinave 12 ml .

Lartesia e skarpates 0.4 – 1 m.

Kendi i pjerresise se faqes per shkembinj te forte 55 – 65 grade.

Forma e transhese eshte e nje trekendeshi te cregullt ku kendi i shpatit do te jete 57° . Sasia e volumit per hapjen e transhes eshte rreth (5) m^3 per 1 ml.

Llogaritja e volumit per transhene $V = 410 \times 5 \times 1 = 2050\text{m}^3$

a) Pershkrim I shkurter I mbuleses bimore te siperfaqes ku propozohet te zbatohet

projekti

Per nga origjina , perberja dhe vecorite gjeobotanike bimesia e Shqiperise ben pjese ne nenzonen floristike mesdhetare e cila perfshihet ne nje njesi me te madhe, ne zonen holarktike. Ndikim te madh ne zhvillimin e flores mesdhetare ushtroi ftohja e pergjithshme e klimes ne periudhen e pleistocentit dhe akullzimi i fuqishem qe pasoi ate. Tiparet karakteristike te bimesise mesdhetare si per sa i perket vecorive gjeobotanike ashtu edhe perberjes morfologjike dhe shtrirjes vertikale te saj, jane karakteristike edhe per bimesine e vendit tone. Por kushtet konkrete te zhvillimit, sidomos te klimes dhe te relievit kane percaktuar edhe vecorite origjinale te flores se Shqiperise.

E gjithë kjo pasuri floristike i detyrohet vecorive te evolucionit paleogjeografik te Shqiperise dhe sidomos larmise se madhe te klimes, copetimit te theksuar te relievit dhe formave te shumellojshme te tij, formacioneve te shumta shkembore (gelqerore, magmatike, terrigjene) etj.

Fitocenozat e bimesise barishtore shume te larmishme nga perberja e llojeve, gjenden ne te gjitha zonat fitoklimatike te Shqiperise. Megjithese fitocenozat barishtore nga ana e fizionomise ne pergjithesi duken relativisht te peraferta, ato ndryshojne midis tyre nga perberja floristike ne varesi te faktoreve ekologjike. Me perjashtime te pakta, gati ne te gjitha fitocenozat dhe bashkeshoqerimet barishtore gjenden perfaqesues te familjes graminore (Graminaceae).

Ne Evrope vendi jone radhitet ne vendet me llojshmeri bimore me te madhe, qe lidhet me ndryshimin e klimes, te tokave, te relievit etj. Ne rajonet perendimore dhe bregdetare mbizotrojne llojet mesdhetare te bimesise si: mareja, shqopa, ilqja, etj., kurse ne brendesi te tyre, bimet e Evropes Lindore dhe Qendrore si: dushku, ahu, bredhi, pisha e zeze etj. Gjithashtu jane te shumta bimet endemike, pra bimet qe riten vetem ne vendin tone. Per shkak te mbizotrimin te relievit kryesisht kodrinoro-malor, qe kushtezon ndryshime te dukshme te klimes dhe te faktoreve te tjere, bimesia eshte e shkallezuar ne drejtimin vertikal ne kater breza: brezi i shkurreve dhe i pyjeve mesdhetare, brezi i dushqeve, brezi i ahishteve dhe i haloreve dhe brezi i kullotave alpine.

Bimesia eshte e shperndare dhe jo uniforme e cila varet nga kushtet klimaterike dhe perberja e shkembinjëve. Pergjithsisht zona e kerkuar per shfrytezim eshte e zhveshur nga bimet drusore, ato qe verehen me teper jane lisi (shkurre) shqope, dellinje, barishte te ndryshme. Shtepia me afer eshte 750m ne JP. Objekti eshte i fshehur nga kodra per fshatin Gjobardhaj dhe nuk do te kete asnje ndikim ne pemet frutore si qeshia, fiku, molla. Vendi qe do te shfrytezohet nuk eshte i lakmueshem edhe per shfrytezim per bageti. Rrjedhimisht shfrytezimi qe kerkon te beje shoqeria nuk ndikon fare ne zhveshmerine e zones dhe demtimet e pemeve frutore(bime te rendesishme) e cila perben avantazh per subjektin kerkues.



b) Informacion per pranine e burimeve ujore ne siperfaqen e kerkuar nga projekti dhe ne afersi te saj

Hidrografia

Nga pikepamja hidrografike zona e marre per shfrytezim eshte e thate. Keshtu qe objekti i Gabrove eshte ne mbyllje te nje kodre me lartesi nga 280 – 330m, siper nivelit te perrojtit te Vomsit 2-3m. Debiti i ketij perroji shkon nga 200l/sek deri 3.5m³/sek ne kohen me shtrengata shiu. Niveli i fundit i shfrytezimit te karrieres eshte parashikuar 280 m dhe uji nuk rrezikon asnjehere shfrytezimin. Materiali steril do te sistemohet perballe me vijen bregore duke u bere prite uji. Ne zonen e marre ne studim kemi ne jug te Kalivaçit lumin e Vomes ne te cilin derdhet prroji i Vomsit qe vjen nga objekti. Lumi i Vomes eshte me teper lume fushor me debit nga (0- 18m³/sek). Ne koheshtrengatash ky lume eshte i rrezikshem sepse transporton mase llumore, prurje te ngurta. Ne VL te objektit me drejtim VL-JP kemi lumin e Gjadrit qe ne periudhen e Veres shteron. Ky lume ka nje debit 15m³/sek deri 30m³/sek. Prania e perrojtit te Vomsit perben avantazh per ujera teknologjik per tu perdorur gjate shfrytezimit te karrieres.

Hidrologjia

Nisur nga llojshmeria shkembore, per zonen e marrre ne studim kemi te bejme me kompleksin e shkembinjeve kompakt.

Ne kompleksin e shkembinjeve me ujembajtje sporadike te çarjeve kemi perfshire: Shkembinjet ultrabazike (verlitet, lercolotet) te Jurasikut te mesem, J2, formacionin vullkanogjeno –sedimentary te T2 –J1, Traktolitit, Gabrot, Gabro - Traktolite te J2. Debiti i ujerave qe lidhen me keto lloje shkembore eshte i vogel nga 0.002 – 0.5 l/sek. Masen kryesore te shkembinjeve te objektit e perbejne traktolitit. Burimet qe lidhen me keta lloje shkembinjesh jane me teper burime çarjesh, verehen raste qe takojme burime me debit te paperfilleshem ne zona te tektonitizuara, zona te serpentinitizuara te cilat banoret i kane kaptazhuar dhe i perdorin per uje te pishem, bujqesi dhe blegtori.

c) Nje identifikim te ndikimeve te mundshme negative ne mjedis te projektit, perfshire ndikimet ne biodiversitet, toke, uje, ajer.

Ndikimet ne biodiversitet

Problemet e biodiversitetit perbejne aktualisht nder problemet më me rendesi ne rruzullin tokesor. Termi biodiversitet eshte shume kompleks dhe si i tille, zhvillimi dhe percaktimi i strategjive te pershtatshme per mbrojtjen e tij, shoqerohet me nje proces te veshtire zgjedhjesh dhe vendimmarrjesh. Biodiversiteti perben teresine e llojeve dhe ekosistemeve ne nje rajon, apo ne gjithë rruzullin tokesor. Ekosistemet jane te nje rendesie te vecante sepse ato perbejn bazat per ekzistencen e llojeve. Cenimi i tyre, si rezultat i aktiviteteve te ndryshme ekonomike shoqerore perben nje shqetesim per njerezit dhe studiuesit . Vlera e nje biodiversiteti te larte per njerezimin jepet para se gjithash nepermjet funksionit te tij si stabilizator i biosferes dhe si burim direkt i prodhimit. Duhet theksuar se siperfaqja qe do te shfrytezohet eshte kodrinore. Aktiviteti shfrytezimit me kariere prek perkohesisht peizazhin ekzistues dhe topografine e saj per gjate kryerjes se aktivitetit . Theksojme se zona shfrytezohet prej 10 vitesh nga shoqeria e cila ka aplikuar edhe per zgjerim te siperfaqes. Me masat qe do merren per rehabilitimin e saj, gjelberimin me bime qe rriten ne zone, gjate shfrytezimit dhe ne mbyllje te aktivitetit , peizazhi dhe topografia e zones do te permiresohet dukshem.

Dëmtimi i vegjetacionit bimor, sidomos gjatë hapjes se karieres dhe shfrytezimit te shkalles se pare dhe te dyte është faktor negativ. Objekti i kerkuar ndodhet prane rruges automobilistike qe lidh fshatrat e zones.

Zona qe do te shfrytezohet nuk ka bimesi te larte eshte plotesisht e zhveshur dhe vende- vende rriten shkurre ku lartesia nuk i kalon 0.5m dhe ne vende te tjera eshte shfaqje shkembore.

Nga ky aktivitet nuk demtohet flora dhe fauna e rrezikuar e percaktuar ne VKM nr. 804. dt. 4.12.2003 dhe e listuar ne urdherin e Ministrit nr. 146,dt.8.5.2007 Nga subjekti ne zbatim te projektit do te merren masa qe zona ne shfrytezim te jete gjithmone e kufizuar dhe te rehabilitohet duke u pyllezuar. Ndersa per te menjanuar erozionin nga ujerat e rreshjeve atmosferike ne skarpaten e siperme te shkalleve do te ndertohen kanale dhe kuneta qe ujerat te drejtohen ne zona qe nuk demtojne token, gjithashtu sheshet e shkalleve te karieres do te hapen me pjerresi nga skarpata e shkalles qe ujerat te rrjedhin ne drejtimin e duhur.

Zona e kerkuar per shfrytezim nuk përfaqëson zone me rëndësi të veçantë dhe për këtë arsye nuk është parashikuar sipas Strategjisë për “Ruajtjen e Biodiversitetit dhe Planit të Veprimit si Zonë e Mundëshme” për tu shpallur “Peizazh i mbrojtur”.

Ndikimet ne toke

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka shkarkime ndotese ne toke, ne vendet e caktuara ne projekt (depozitat e sterileve) parashikohet depozitimi i materialit te paperdorshem dhe perpunimi i tij me toke vegetale per te mundesuar mbjelljen e bimeve dhe pemeve karakteristike te zones gjate fazes se rehabilitimit. Sasia e prgjitheshme e zbulimit, per te gjithë karrieren, parashikohet te kryhet duke filluar nga viti i pare dhe gradualisht ne vitet e tjera ne vazhdim

Sasia e pergjitheshme e zbulimit do te depozitohet ne sheshin fundor te karrieres, +50 brenda kufijve te siperfaqes se kerkuar. Ne planimetrine perkatese eshte konturuar siperfaqja e depozitimit te sterileve. Sasia e pergjitheshme e zbulimit do te depozitohet perkohesisht dhe pjeserisht ne pjesen fundore te karrieres, brenda kufijve te siperfaqes se kerkuar. Ne planimetrine perkatese eshte konturuar siperfaqja e depozitimit te sterileve. Sterilet e depozituara do te perdoren per rehabilitimin progresiv te karrieres i cili do te realizohet sipas projektit per rehabilitimin e karrieres ne fund te shfrytezimit.

Ndikimet ne uje

Ne procese teknologjike te shfrytezimit te gurit dekorativ gabro, me kariere nuk do te perdoret uji. Aktiviteti do te prodhoj gur gelqeror dekorativ i cili do te sherbeje si lende e pare ne industrine e ndertimit. Ne dite me rreshje ne kariere nuk punohet.

Ujerat e shiut do te sistemohen permes hapjes se kunetave dhe kanaleve per drenazhim dhe disiplinimin e ujerave te rreshjeve atmosferike.

Uje do te perdoret per sperkatje per eliminim te pluhurave qe krijohen gjate shfrytezimit te shkalleve te karrieres.

Ndikimet ne ajer

Zhvillimi i aktivitetit do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis gjate shfrytezimit te karrieres, burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete. Pajisjet qe do te perdoren per shfrytezimin dhe transportin e gurit gelqeror dekorativ do te jene bashkohore dhe ne gjendje te mire teknike ne menyre qe te shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegese qe ato perdorin.

Shfrytezimi i gurit gelqeror dekorativ me kariere eshte nje proces i thjeshte pune me nxjerrje te blloqeve, ngarkim te prodhimit me eskavator dhe transport me kamione. Meqenese nuk do te perdoren ne procesin e shfrytezimit lende te demshme, nuk do te kete shkarkime te lendeve kimike te demshme per mjedisin ne ajer, toke dhe uje. Siperfaqja qe do t'i nenshtrohet shfrytezimit nuk eshte toke bujqesore produktive. Ushtrimi i aktivitetit ne kete siperfaqe nuk ndikon negativisht ne cilesine dhe sasine e tokes bujqesore. Tokat bujqesore ndodhen jasht zones ku do te kryhet aktiviteti.

Ndikimet e identifikuar nga zhvillimi i aktivitetit jane ndikime direkte ne mjedis.

Tabela e identifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne toke.

	Ndikimi i mundshem	Sqarim
1	Derdhja pa dashje e vajrave dhe lubrifikanteve nga mjetet e punes.	Behet fjale per ndonje rast te rralle te rrjedhjes gjate difekteve dhe çarje te tubave dhe sotokartit te mjeteve motorike dhe nderrimit te vajrave ne makinerite e karrieres gjate prodhimit dhe transportit te materialit.

Tabela e identifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne ajer.

	Ndikimi i mundeshem	Sqarim
1	Shkarkimi i gazeve ne sasi minimale nga lenda djegese	Sasia e gazeve nga djegia e karburantit qe do te shkarkohet nga mjetet motorike. Eshte standart i teknologjise se prodhimit te mjeteve dhe i karburantit.
2	Emetimi i zhurmave nga puna e makinerive te karrieres.	Vlerat standart te emetimit te zhurmave sipas teknologjise se prodhimit te makinerive, kontroll teknik te makinerive te shoqerise.

Tabela e indentifikimit te ndikimeve te mundeshme negative ne biodiversitet.

	Ndikimi i mundeshem	Sqarim
1	Shqetesim i mundeshem i faunes.	Ndikim i perkoshem.

d) Nje pershkrim te shkurter per shkarkimet e mundshme ne mjedis te tilla si , ujera te ndotura, gaze dhe pluhur, zhurme, si dhe prodhimin e mbetjeve

Uji do perdoret per lagjen e territorit per paksimin e pluhurave gjate procesit te nxjerrjes se gurit gelqeror dekorativ do sigurohet permes depozitave nga shoqeria.

Ujerat e shiut do te sistemohen permes kanaleve perimetrike dhe me pas do i bashkohen ujrave te çarjeve, debiti i te cilave varet nga reshjet atmosferike. Theksojme se ujerat nuk permbajn elemente kimike ndotes.

Zhvillimi i aktivitetit do te sjell emetime te pluhurave ne mjedis gjate shfrytezimit te karieres, burime te tjera ndotese per ajrin nuk do te kete. Pajisjet qe do te perdoren per shfrytezimin dhe transportin e gurit gelqerore dekorativ do te jene bashkohore dhe ne gjendje te mire teknike ne menyre qe te shmangen emetimet nga djegia e lendeve djegese qe ato perdorin.

Ky aktivitet do te kryhet larg zonave te banuara, ne shpatin e kodres me depozitime gjeologjike te gurit gelqeror dekorativ. Aktiviteti i shfrytezimit te vendburimit do te behet ne nje zone te kufizuar ne krahasim me siperfaqen dhe popullsine e rajonit. Per zhvillimin e aktivitetit nuk do perdoret toke shtese vec asaj te miratuar per shfrytezim.

Zhurmat ne fazen e ndertimit kryesisht vijne :

- nga makinerit qe do perdoren per pergatitjen e shesheve te shkalleve te shfrytezimit te karieres.

Gjate fazes se pare te ndertimit paisjet e perdorura do te jene nje eskavator qe do te hap shkallet e karieres dhe fadroma e pastrimit te sheshit .

Makinerit dhe niveli i pranueshem i zhurmave

<i>Lloji makinerise</i>	<i>fuqia motorike P (kw)</i>	<i>niveli pranueshem i zhurmes db</i>
<i>Eskavator me zinxhira Fadrome</i>	<i>p = 55</i>	65
<i>Eskavator, paisje ngritese Transportues, sonde, etj</i>	<i>p = 15</i>	65
<i>Matrapik ne eskvator</i>	<i>p = 15</i>	66

Paisjet e makinerit qe do perdoren ne kete aktivitet do plotesojne direktiven 2000/1/14/CE te Parlamtetit Evropian dhe e KE 8 maj 2000, do jene te standartit te aplikueshem ne BE per zhurmat.

Ndikimi nga zhurmat ne fazen funksionale te aktivitetit

Burimet e zhurmave jane ne siperfaqe. Çdo burim perhap vale zhurme. Fusha akustike qe rezulton varet nga karakteristikat e absorbimit dhe reflektimeve te te gjitha pengesave ekzistuese, ndermjet burimit dhe receptorit.

Energjia zvoglohet per gjate rruges si rezultat i absorbimit te siperfaqeve, divergjences gjeometrike dhe absorbimit atmosferik.

Program i përdorur për llogaritjen e nivelit të zhurmave merr parasysh faktori
“A” – niveli i presionit të zhurmës të llogaritur
Faktori « A » përbehet nga kontribuesit që vijojnë

Niveli i fuqisë së zhurmës në drejtim të përhapjes $L_{ne \text{ drejtim të eres}}$, llogaritet për çdo burim

$$L_{ne \text{ drejtim të eres}} = L_{W_} - A$$

Ndikim të zhurmave do të ketë gjatë procesve të punës së shfrytëzimit.

Niveli i zhurmave të këtyre makinerive, është i atij niveli që nuk influencën si për të punësuarit dhe për banorët dhe gjallesat për rreth tij.

Niveli i zhurmave nga puna e njëkohshme e makinerive në distancë 7 m nga to, është më i vogël se 70 dB. Duke marrë parasysh shprehjen e nivelit të intensitetit akustik të një zhurmë me relacionin e mëposhtem :

$$L = 10 \lg(I_1/I_0) \text{ ku}$$

L - Niveli akustik i zhurmës të marrë në konsideratë .

I_1 - Intensiteti akustik i zhurmave

I_0 - Intensiteti akustik i referencës

Vlerësojmë se niveli akustik i zhurmës në rrugë është më i ulët se ai i zhurmës së një makine që kalon në të, praktikisht ai është 40-50 dB që i përgjigjet kushteve të një bisede me zë normal.

Fenomene të tilla si vibracion, ndricim, nxehësia janë të papërfillshme në zhvillim të këtij aktiviteti në këto objekt.

Siç thame edhe më sipër, zhurmat që do të krijohen gjatë procesit të punës në objekt janë vetëm ato të shkaktuara nga makineritë e shfrytëzimit, të ngarkimit e të transportit të cilat ato janë brenda normave.

Nga kryerja e aktivitetit minierar për shfrytëzimin e gelqeroreve dekorativ, mbetjet e ngurta do të jenë mbulesa vegjetale dhe copa të gurit gelqeror dekorativ. Përse i përket mbetjeve sterile ato do të depozitohen në vendin e caktuar në projekt (depozitat e sterileve), këtu parashikohet depozitimi i materialit të përdorshëm dhe përpunimi i tij me tokë vegjetale për të mundësuar mbjelljen e bimëve dhe pemëve karakteristike të zonës gjatë fazës së rehabilitimit. Dherat e depozituara në damba do të përpunohen me dhera të pasuruara me humuse, do të transportohen dhe shpërndahen në sheshet e shkalleve me trashësi mbi 20 cm dhe do të pyllëzohen me bimë që rriten në zonë për gjelberimin e saj. Keto sterile nuk janë ndotëse për mjedisin tokësor sepse kanë të njëjten përzierje mineralogjike me tokën ku do të depozitohen.

e) Informacion për kohezgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar

Gjatë fazës normale të operimit të projektit nuk do të ketë emetime të gazeve, lëngjeve, mbetjeve toksike, helme të ndryshme dhe substanca të tjera të dëmshme, të cilat mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e punonjësve, banorëve dhe mjedisin përreth, floren dhe faunën e zonës, burimet ujore. Shfrytëzimi i gurit gelqeror dekorativ me kariere është një proces i thjeshtë pune me nxjerrje të blloqeve, ngarkim të prodhimit me eskavator dhe transport me kamione. Mëqenëse nuk do të përdoren në procesin e shfrytëzimit lëndë të dëmshme, nuk do të ketë shkarkime të lëndëve kimike të dëmshme për mjedisin në ajër, tokë dhe ujë. Sipërfaqja që do të nenshtrohet shfrytëzimit nuk është tokë bujqësore produktive. Ushtrimi i aktivitetit në këto sipërfaqe nuk ndikon negativisht në cilësinë dhe sasinë e tokës bujqësore. Tokat bujqësore ndodhen jashtë zonës ku do të kryhet aktiviteti.

Persa i perket ndikimit ne peizazhin ekzistues dhe topografine e saj do te zgjas per gjate kohes se kryerjes se aktivitetit. Me mbylljen e aktivitetit dhe masat rehabilituese zona e shfrytezuat do te kthehet ne nje peizazh me pamje panoramike te pelqyeshme nga syri i njeriut.

- f) Te dhena per shtrirjen e mundshme hapesinore te ndikimit negative ne mjedis, qe nenkupton distancen fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara qe perfshihen ne te.**

Duke njohur teknologjine, operacionet ne terren dhe menyren e shfrytezimit te objektit u identifikuan ndikimet e mundeshme negative ne çdo receptore - perberes te mjedisit ne objekt.

Identifikimi i ndikimeve – Permes te cilit u percaktua nderveprimi mjedis-projekt i prodhimit te gurit gelqerore dekorativ dhe u identifikuan ndikimet e mundshme gjate kesaj faze sipas receptoreve te mjedisit.

Vleresimi i ndikimeve – Ekspertet mjedisore te fushave te ndryshme bene perpjekje per matjen e gravitetit te ndikimeve . Vleresimi i Sinjifikances ka te beje me vete rendesine e ndikimeve dhe eshte faza me e rendesishme per zbatuesit e projektit sepse argumenton çdo ndikim negativ dhe perafroon ate me objektivisht me teresine e bashkeveprimeve midis projektit dhe mjedisit. Kriteret e perdorur per vleresimin e rendesise se ndikimeve variojne dhe drejtohen kryesisht nga vlerat e mjedisit te ndikuar.

Shtrirja fizike- Vlereson siperfaqen apo dimesionin hapsinore te nje ndikimi te dhene ne raport me burimin qe gjeneron ate ndikim, p.sh. ndikimi ne toke nga shfrytezimi eshte nje ndikim saktisht i percaktuar i cili mund te matet , por ne se do te ket erozion te tokes ndikimi rritet ne permasa fizike te siperfaqes se marre per studim.

- **Kohezgjatja e ndikimit** – Vlereson se sa do te zgjase nje ndikim i caktuar ne dimesionin kohe (ndikim i perhershem apo i perkoshem). Ne rastin tone shfrytezimi i gurit gelqerore dekorativ eshte e perhereshme per nje afat qe do perkoj me lejen minerare. Ndersa te gjitha ndikimet e tjera negative ne mjedis jane te perkoshme, si shkarkimet e ujit te rreshjeve, emetimet e pluhurave, etj

-Kthyesmeria –Vlereson mundesin e kthimit te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e tij te me pareshme (aftesia per tu rehabilituar dhe regjeneruar)

-Rendesia – Realizon nje vleresim total te tre permasave te mesiperme dhe njekohesisht thekson vemendjen qe duhet patur per administrimin e ndikimit.

Ndikimet e parashikuara nuk kane shtrirje te madhe fizike, objekti i shfrytezimit ndodhet ne distance te konsiderueshme nga zona me e afert e banuar dhe nuk preket nga zhvillimi i ketij aktiviteti. Zhurmat qe krijohen gjate hapjes dhe shfrytezimit te shkalleve te karieres nuk perbejn ndotje akustike. Analiza e frekuences te zhurmes te emetuar nga keto makineri dhe pajisje tregon se ato ndodhen nen mesataren e frekuences 100 – 150 Hz , e cila eshte e pranueshme nga veshi i njeriut . Koha ne te cilen do te jene te pranishme keto zhurma eshte vetem gjate dites, meqenese ne objekt do punohet vetem me nje turn. Niveli i zhurmave te ketyre mjeteve ne largesi nuk do te jete i madh dhe do te jete konform normave ne fuqi.

- g) Mundesine e rehabilitimit te mjedisi te ndikuar dhe mundesine e kthimit te siperfaqes te mjedisit te ndikuar ne gjendjen e meparshme, perfshire edhe token bujqesore , si dhe kostot financiare te peraferta per rehabilitimin**

Drejtimet kryesore te projektit per reabilitimin e karieres te shfrytezimit te Gabrove

1. Lidhja e shesheve te shkalleve te shfrytezimit me rruge automobilistike

Me projekt sheshet e shkalleve ne mbyllje te aktivitetit do te kene gjeresi 3 m lartesi shkalle 10m dhe kend pjerresie te skarpates 68° - 73°

Sheshet e shkalleve me projekte do te lidhen midis tyre me rruge automobilistike e cila do te kete funksion sherbimi, per lehtesimin e levizjeve te njerezve, transportin e dheut qe do te vendoset ne sheshet e shkalleve, transportin e drureve dekorativ dhe bimesise qe do te perdoret per reabilitimin dhe gjelberimin karieres, etj.

2. Ndertimi kunetave dhe kanaleve te drenazhimit te ujrave siperfaqesore per mbrojtjen e karieres nga erozioni

Per mbrojtjen e karieres nga rrjedhjet e ujrave te rreshjeve atmosferike qe mund te vijne nga zona mbi kufirin e siperme te shfrytezimit kuota +380 m qe perkon dhe me skarpaten e shkalles se pare te shfrytezimit, do te ndertohet ne kete horizont nje kunet ne gjithe gjatesine e skarpates se siperme te saj.

Ujrat e grumbulluara ne kete kunet do te drejtohen ne pjeset anesore te karieres drejte kolektorit te ujrave te siperme.

Gjithashtu ne cdo shesh shkalle ne pjesen fundore te skarpates do te hapen kanale me dimensione 50x40x20cm per kullimin e ujrave te rreshjeve atmosferike te cilat do te drenohen poshte kontureve te karieres.

Me keto masa shmangen grumbullimet e ujit ne gropa dhe erozioni i shesheve te shkalleve te shfrytezuara ne kariere.

3. Grumbullim dheu, perpunim me humus i tyre, transporti dhe shtrimi ne sheshet e shkalleve te shfrytezuara

Per reabilitimin e siperfaqes se shfrytezuar meqene se sheshet e shkalleve perbehen nga material shkembor, per te krijuar kushte optimale per rritjen drureve dhe bimesise qe do te mbillet, ne siperfaqet e sheshit te shkalleve te shfrytezimit do te vendoset nje shtrese dheu e pasuruar me humuse me trashesi 0.2 m.

-MASAT REHABILITUESE

Punimet qe do te kryen per reabilitimin e zones se shfrytezuar

-Punime inxhinierike

-Punime biologjike

-Punime inxhinierike

-Hapja dhe mirembajtja e rrugeve automobilistike per hyrje ne sheshin e sigurise se shkalleve

-Hapja e kunetave dhe kanaleve per drenazhim dhe disiplinimin e ujrave te rreshjet atmosferike

-Punime biologjike

- Mbushja me dhera humusore me trashesi 30cm te shesheve te shkalleve dhe pergatitja e tokes per mbjellje me bimesi.
- Mbjellja e fidaneve qe rriten ne kete zone
- Mbjellja e bimesise.
- Sherbimet profilaktike ne siperfaqet e rehabilituara.

-Ana biologjike

Zona eshte me depozitime gure gelqerori dekorativ qe nuk kane bimesi shume te zhvilluar. Ndryshueshmeria biologjike e zones kushtezohet nga veprimi i klimes mesdhetare. Ne kete zone eshte prania e shkurreve mesdhetare. Bimesia drunore e larte ne formen e pyjeve pothuajse mungon dhe dominohet nga llojet e shkurreve mesdhetare. Gjitaret e medhej qe takohen ne kete zone jane dhelpra, lepuri i eger numri i te cilit eshte zvogeluar , nusja e lales etj. Nga shpendet me shpesh takohen thelleza, trumcaket, gushkuqietj. Gjithashtu takohen zvarranik te ndryshem si gjalperinj, hardhuca, breshka, nje numer i pakufizuar insektesh, milingona, etj. Rehabilitimi zones se shfrytezuar duke u gjelberuar dhe pyllzuar do te permiresoje cilesine e ajrit floren dhe faunen e zones, etj. Mbas rehabilitimit te cdo sheshi do te kryhen te gjitha sherbimet e nevojshme per mbirjen dhe mirembajtje te tyre. Ne teresi, ne funksionimin e ekosistemeve te tjera nisur nga koncepti i teresise ekologjike keto habitate kane vlera dhe duhet te ruhen dhe rehabilitohen. Flora dhe vegjetacioni i kesaj zone dominohen nga shkurre te egra. Ne kete kat shkurre ka si mbulesa ne masen me te madhe te tij bimesia barishtore qe zhvillohet ne varesi te drejtperdrejte te mikroklimave dhe eshte rezultat i veprimtarise antropogjene.

-Punime biologjike biodiversiteti

Ndryshueshmeria biologjike e zones kushtezohet nga veprimi i klimave mesdhetare. Ne kete zone eshte prania e bimesise mesdhetare te shkurreve te ulta dhe barishteve si dhe te ferrave . Bimesia e larte ne fomen e pyjeve masive mungon dhe dominohet nga llojet e siperpermendura dhe dushknajat qe jane deshmitare te pranise se tyre masive ne te kaluaren. Nisur nga koncepti i teresise ekologjike keto habitate kane vlera dhe duhet te rehabilitohen. Per kete ne zonen e kryerjes se punimeve do te mbillet bimesia e zones dhe bimesi e kultivuar ne te gjitha sheshet e sigurimit qe do te dalin per cdo horizont shfrytezimi. Pervec filizave do te mbillen edhe bimet barishtore ne sheshet e shkalleve per te krijuar siperfaqe te gjelber. Mbjellja e tyre do te permisoje ne menyre te dukshme pejsazhin e zones dhe do te ndikoj ne rritjen e popullimitit e numrit te gjitareve, shpendeve dhe zvarranikeve, sepse do te krijohen kushtet e nevojshme per zhvillimin e tyre, te folezimit dhe do te eliminohet fenomeni i erozionit.

h) Masat e mundshme per shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative ne mjedis

Masat zbutese te ndikimeve negative konsistojne ne marrjen e masave per uljen e ndotjeve gjate punimeve, ne ajer, te pluhurave dhe zhurmave, si dhe uljen e efekteve negative hapsinore te territorit , faunen dhe floren. Me qellim minimizimin e efekteve negative mjedisore dhe rritjes se efekteve pozitive ne mjedis, nga ana e shoqerise do merren masa per zbutjen dhe minimizimin e efekteve negative ne mjedis.

Planifikimi i zones

Per shmangien dhe parandalimin e erozionit si dhe per ruajtjen e regjimit te rrymes se ujit te parametrave hidrodinamike te saj, ne projekt eshte percaktuar shfrytezimi harmonik dhe i kombinuar ne kohe dhe hapësire i zones ne teresi . Ne zonen e shfrytezimit hap pas hapi dhe ne perfundim te aktivitetit, eshte parashikuar sistemi i sterileve qe do te dalin nga aktiviteti si dhe rehabilitimi i shkalleve te karrieres. Kjo siperfaqe e perftuar nga trajtimet e mesiperme, do te jape mundesi per rikultivimin e bimeve te zones , duke krijuar njeheresh kushte per parandalimin e erozionit dhe permiresimin e pamjes se pergjithshme te zones .

Masat qe do te merren per zbutjen e ndikimit

Ndikimet mjedisore te projektit do te zbuten duke zbatuar me korrektesi teknikat e meposhtme:

- Piketim te sakte te siperfaqes ku do te shfrytezohet
- Kontrolli i pluhurave nepermjet lagies se zones se shfrytezimit, mbulimit te kamioneve gjate transportit sidomos ne kohet e thate dhe me ere.
- Mbjellje me filiza, pise, akacie, bimesi mesdhetare qe rriten ne zone te gjithe periferise me te larte te shpatit te territorit gjate shfrytezimit. Kjo mase do te sherbeje edhe per uljen e nivelit te pluhurave dhe zhurmave ne vazhdim te projektit, si dhe te rrise mundesimin per vetegjenerim te drureve ne pjesen e larte me shpatin tjetet te kodres.
- Uljen e tensionit te shfrytezimit per stinen e veres duke evituar keshtu me sa te jete e mundur erozionin dhe pluhurat. Nga ana tjetet per te ulur efektet erodike, gjate periudhave te thata do te perdoret lagia e terreneve ne pune dhe sidomos, lagia e materialit te nxjere. Kjo do te evitoje edhe ndotjen gjate transportit (materiali i thate krijon pluhura).

- Kontrollin e dherave te gjeneruara dhe sistemimin e tyre nepermjet kompakesimit dhe mbjelljes se shkurreve qe do te dalin nga pastrimi dhe mirmbajtja me qellim rivegjetacionin e ambientit perreth perimetrit te zones qe do te shfrytëzohet. Do te zbatohen me rigorozitet kushtet e sigurit teknik per punonjesit
- Hapjen e kanaleve te nevojshem me qellim drejtimin e ujerave te shiut dhe erozionit per parandalimin e shembjes se sipërfaqes dhe vithisjeve te ndryshme.
- Kontroll teknik i mjeteve te punes per te parandaluar rrjedhjet e karburantit dhe aksidentet e mundshme

Per te ulur ne minimum ndikimet nga zhurmat do te merren keto masa:

- o Makinerit e ngarkimit dhe transportit te mineralit do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore, te pajisura ne marmita silenciatore te pakesimit te zhurmave.
- o Per te ulur me tej ndikimin nga zhurmat punetoret detyrimisht do te perdorin paisjet e mbrojtjes ne pune "kufje"

Brenda zones karieres vlerat e zhurmave jane gjithmone poshte normave te lejuara. Jane bere matje te nivelit te zhurmave ne disa objekte te ngjashme ku perdoren te njejtat makineri dhe del se ne distancen 10m nga makinerit zhurmat arrijne nivelin 70 dB.

Emetimet ne ajer perfaqsohen nga pluhuri qe krijohet gjate nxjerrjes, ngarkimit te gurit gelqeror, levizjes se makinerive ne territorin e karieres ndersa ndikimi nga gazet shkaktohet nga mjetet motorrike, eskavatoret, fadromat, kamionet dhe mjetet e tjera motorrike qe levizin ne kariere.

Me projekt per mbrojtjen nga pluhuri do te merren keto masa.

Per te eleminuar pluhurin qe krijohet gjate nxjerrjes dhe ngarkimit te gurit gelqeror dekorativ , transportit dhe levizjes se mjeteve ne shkallet e karieres, materiali qe ngarkohet dhe sheshet e shkalleve do te lagen me uje, ndersa makinat do te mbuloohen me mushama.

Duke marre ne konsiderate prodhimin ditor pluhurat gjate nxjerrjes dhe ngarkimit do te jene minimale.

Per mbrojtjen nga gazet e motorreve dizel do te merren keto masa.

Mjetet motorrike do te jene bashkekohore qe plotesojne standartet shteterore. Ato do te jene te pajisura ne marmita me katalizatore per kapjen e gazeve toksike.

Meqenese qendrat e banuara jane ne nje distance relativisht te larget nga zona e shfrytezimit, keto emetime nuk ndikojne ne to.

Gjithashtu nuk do te kete ndikim tek punonjesit e karieres, floren dhe faunen per rreth saj.

Per zbutjen e ketyre ndikimeve mbi punonjesit e karieres ata do te pajisen me mjete mbrojtese nga pluhuri dhe gazet.

Masat teknike,

Per parandalimin e erozionit, shembjes dhe vithisjeve te ndryshme, ne zonen e shfrytezimit subjekti parashikon, cdo vit, te kryeje punimet e meposhteme:

Pas perfundimit te shfrytezimit qe ne vitin e pare te aktivitetit shfrytezues te nje pjese te shkalles se pare, ne sheshet e krijuara dhe kryesisht ne sheshin e lene per kete qellim, do te ridepozitohen hap pas hapi ne cdo vit mbetje te ndryshme te zbulimit te cilat perbehen nga depozitime deluvionale produktive;

Depozitimi i tyre behet me qellim te parandalimit te erozionit te shpateve dhe per t'i paraprire mbjelljes se bimeve dhe pemeve karakteristike te zones;

Gjate ushtrimit te aktivitetit te shfrytezimit do te ruhen parametrat gjeometrike dhe gjeomekanike te shkalleve te shfrytezimit te parashikuar ne projekt;

Sistemimi, krefja dhe skarifikimi i skarpateve te shkalleve te shfrytezuara do te behet ne menyre sistematike, sipas parametrave gjeometrike te percaktuar ne pjesen perkatese te projektit;

Gjate shfrytezimit dhe ne perfundim te tij do te ruhen parametrat e pjerresise se shkalleve dhe te siperfaqeve te mbuluara per te lejuar rrjedhen normale te ujerave te rreshjeve dhe parandaluar grumbullimin dhe shpelarjen e siperfaqes se shfrytezuar dhe te mbuluar;

Masat estetike dhe ekologjike

Gjate ushtrimit te aktiviteti te tij, subjekti i licensuar do te kryeje cdo vit proceset e me poshteme:

- Sistemimin e skarpateve perfundimtare te shkalleve te shfrytezimit duke respektuar parametrat gjeomekanike dhe gjeometrike te tyre;
- Lenien e brezave mbrojtjes midis kufijeve te zones se shfrytezimit dhe siperfaqes tjeter (jashte kufirit te zones);
- Sistemimin , perpunimin dhe mbulimin e siperfaqeve horizontale te shkalleve duke i kthyer ato ne forme brezaresh;
- Krijimin e kushteve te pershtateshme per mbjelljen dhe kultivimin e bimeve dhe pemeve te ndryshme lokale;
- Mbjelljen e siperfaqeve te shkalleve me bime dhe peme , kryesisht me shkurre te ndryshme dhe bime te tjera , te cilat jane karakteristike per zonen.

I) Ndikimet me natyre nderkufitare (nese projekti ka natyre te tille).

Zhvillimi i aktivitetit nuk ka ndikime me natyre nderkufitare, zhvillohet ne lindje te fshatit Gjobardhaj, Ungrej, Lezhe.